

15 prill 2016

Misioni i OSBE-së në Bosnjë-Hercegovinë, në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë Penale, Studimet për Kriminologjinë dhe Sigurinë, në Universitetin e Sarajevës dhe në partneritet me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, Misionin e OSBE-së në Kosovë, Misionin e OSBE-së në Mal të Zi, Misionin e OSBE-së në Serbi dhe Misionin e OSBE-së në Shkup, ka kënaqësinë të shpallë:

## FTESË PËR ESE

Reflektim për krimet e motivuara nga urrejtja. Punimi do të prezantohet në konferencën “**Krimet e Urrejtjes në Evropën Juglindore**”, që do të zhvillohet në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, më 8 nëntor 2016.

Efekti thelbësisht negativ i krimeve të urrejtjes shpesh nënvlerësohet. Krimet e urrejtjes kërcënojnë jo vetëm sigurinë fizike të individëve, por vetë ekzistencën dhe bashkëjetesën e komunitetit. Krimet e motivuara nga urrejtja kanë ndikim tejet të fortë te viktimat dhe përcjellin te grupe të tëra mesazhin e përjashtimit dhe mungesës së tolerancës.

Krimet e urrejtjes në Evropën Juglindore kanë shumë tipare dhe modele të përbashkëta, gjë që e legjitimon fokusin rajonal të konferencës. Konferenca mbledh ekspertë rajonalë në fushën e krimeve të urrejtjes, me qëllim që të eksplorojnë aspektet ligjore dhe sociologjike, si edhe të forcohet diskutimi mbi praktikën e mira për trajtimin e kësaj sfide, duke pasur në qendër rolin e sistemit të drejtësisë penale.

Jeni të ftuar të dorëzoni esetë tuaja për temat e mëposhtme:

- Reagimi i drejtësisë penale ndaj krimeve të urrejtjes, duke u përqendruar veçanërisht tek: elementët penalë të krimeve të urrejtjes dhe nxitjes së urrejtjes; shtrirja e karakteristikave të mbrojtura; motivi diskriminues, si element përbërës i një krimi të rëndë apo si rrethanë rënduese; dallimi dhe lidhja midis krimit të motivuar nga urrejtja dhe nxitjes së urrejtjes; përdorimi i procedimeve për kundravajtje për të trajtuar krimet e urrejtjes dhe nxitjen e urrejtjes; problematikat lidhur me dënimet që jepen për krimet e urrejtjes dhe nxitjes për urrejtje; sfidat dhe praktikën e mira në hetimin dhe mbledhjen e provave për krimet e urrejtjes.
- Aspektet sociologjike të krimeve të urrejtjes, me fokus të veçantë te: kriminologjia e krimeve të urrejtjes dhe nxitjes së urrejtjes; viktimologjia e krimeve të urrejtjes dhe nxitjes së urrejtjes.

së urrejtjes; lidhja midis krimeve të urrejtjes, radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm; parandalimi i krimeve të urrejtjes.

Përparësi kanë esetë që i trajtojnë këto çështje nga perspektiva e të paktën një prej vendeve të Evropës Juglindore. Gjithashtu, inkurajojmë esetë krahasimore.

Esetë mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, boshnjake, kroate, angleze, maqedonase, malazeze dhe serbe.

Propozimet për ese dhe vetë esetë shqyrtohen nga një bord vlerësuesish. Esetë që do të përzgjidhen për t'u prezantuar në konferencë do të publikohen si punime të konferencës nga Fakulteti i Drejtësisë Penale, Studimeve për Kriminologjinë dhe Sigurinë, në Universitetin e Sarajevës, në gjuhën origjinale, në gjuhët zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës dhe/ose në anglisht.

Kostot e pjesëmarrjes në konferencë për autorët e përzgjedhur mbulohen nga OSBE-ja.

Afati për dorëzimin e propozimeve dhe eseve:

8 maj 2016	Afati për dorëzimin e propozimeve për ese (deri 300 fjalë)
8 qershor 2016	Njoftimi se cilat propozime për ese janë përzgjedhur
15 gusht 2016	Afati për dorëzimin e eseve (5 000 deri 10 000 fjalë)
30 shtator 2016	Njoftimi se cilat ese janë përzgjedhur

Për informacion shtesë dhe për dorëzimin e propozimeve për ese (**bashkë me CV-në tuaj**), mund të na kontaktoni në: [SEEHateCrimesConference-BA@osce.org](mailto:SEEHateCrimesConference-BA@osce.org)